BULETINI JAVOR
23-27 TETOR 2023

Shprehja e javës

"Në hapsirën digjitale, siguria nuk është një destinacion, është një udhëtim.

Përmbajtja:

- **Autoriteti Kombëtar për Cesk organizon trajnime përgatitore së bashku me stafin e Monitorimit të Incidenteve**
- **Këshilla sigurie për sektorin e transportit**



Autoriteti Kombëtar për Cesk organizon trajnime përgatitore së bashku me stafin e Monitorimit të Incidenteve

Sulmet e ransomware, leak data, privilege escalation dhe incidentet e tjera të ndryshimit të informacionit janë përgjegjësi e një sfide të mëtejshme për organizatat dhe jo vetem.

AKCESK ,në kuadër të mbrojtjes së të gjithë Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit, kryen rregullisht ushtrime përgatitore dhe simulime të sulmeve së bashku me stafin e Monitorimit të Incidenteve (Albanian National SOC), kjo për të rritur reagimin në rast incidentesh, si dhe monitorimin e sigurisë kibernetike nëpërmjet platformave efikase SIEM apo Threat Intel.

Stafi njihet vazhdimisht me teknikat më të fundit që hakerat përdorin për të thyer sisteme sigurie apo duke anashkaluar mbrojtjet e sistemeve të ndryshme monitoruese, nëpërmjet prezantimeve Table Top Excercise rreth Social Engineering, Ransomware dhe Leak Data si dhe nëpërmjet Cyber Drill.

Këshilla Sigurie për Sektorin e Transportit

"Rruga drejt progresit është gjithmonë në ndërtim e sipër dhe në epokën digjitale, nuk është vetëm asfalti dhe betoni që kanë nevojë për mirëmbajtje, por edhe algoritmet dhe masat e sigurisë kibernetike që hapin rrugën për transport më të sigurt dhe më të zgjuar".

Kufizoni aksesin në sistemet tuaja

Pavarësisht nga industria , një nga linjat më të mira të mbrojtjes kundër sulmeve kibernetike është praktika e kufizimit të aksesit në sistemet tuaja dhe të dhënat e ndjeshme.



Përditësoni gjithmonë

Teknologjia dhe sulmet kibernetike po përmirësohen vazhdimisht, prandaj është jetike që të përditësoni vazhdimisht proceset, sistemet, softuerin dhe politikat tuaja.

Trajnoni të gjithë stafin tuaj



Shumë sulme të sigurisë kibernetike ndodhin si rezultat i pakujdesisë ose mungesës së ndërgjegjësimit të fuqisë punëtore. Investoni burimet dhe kohën tuaj në procesin e trajnimit sa më shpejt të jetë e mundur.

Rruga "Papa Gjon Pali II", No.3
info@cesk.gov.al
Autoriteti Kombëtar për CESK
autoriteti_kombetar_cesk
+35542221039

BULETINI JAVOR
23-27 TETOR 2023

Shprehja e javës

"Në hapsirën digjitale, siguria nuk është një destinacion, është një udhëtim.

Përmbajtja:

StripedFly malware infekton 1 milion hoste Windows dhe Linux

Një platformë e sofistikuar malware e quajtur StripedFly zbulohet se ka infektuar për pesë vjet mbi një milion sisteme Windows dhe Linux.
Studiuesit zbuluan natyrën e vërtetë të platformës keqdashëse vitin e kaluar, duke gjetur prova të aktivitetit të tij që nga viti 2017.
Edhe pse është ende e paqartë nëse ky malware është përdorur për gjenerimin e të ardhurave ose spiunazh kibernetik, studiuesit njoftojnë se ky është një malware APT (Advanced Persistent Threat)

Link:Lexo më shumë

Pesë spitale në Ontario janë prekur nga një sulm kibernetik

Një sulm kibernetik i cili preku drejtpërdrejt Organizatën TransForm Shared Service, e cila ofron shërbime IT në pesë spitale në Ontario , Kanada, ka patur një ndikim të madh në operacionet e pesë njësive spitalore.

Organizata TransForm Shared Service njoftoi se po hetonte "shkakun dhe shtrirjen e incidentit, duke përfshirë nëse informacioni i pacientit ishte prekur" dhe do të jepte informacion të përditësuar sipas nevojës.

Link:Lexo më shumë

Zbulohet një malware i ri i maskuar si përditësim i ri i Google Chrome

Studiuesit e sigurisë paralajmëruan për një fushatë të re të rremë përditësimi lidhur me shfletuesin Google Chrome. Fushata është duke përdorur një malware të ri, të quajtur FakeUpdateRU, i cili u përdor për të mashtruar përdoruesit për të shkarkuar një trojan .

Fushata fillimisht doli në dritë pasi malware kishte ndikuar tashmë në faqe interneti të shumta, të cilat më vonë u adresuan nga Google.

Link: Lexo më shumë

PATCHING ALERT

VMware - patching alert

VMware ka publikuar përditësime sigurie për të adresuar një vulnerabilitet kritik të identifikuar si CVE-2023-34048(CVSS: 9.8), i cili mund të rezultojë në ekzekutimin e kodit në distancë në sistemet e prekura.

VMware njoftoi se nuk ka zgjidhje për të zbutur vulnerabilitetin dhe se përditësimet e sigurisë janë vënë në dispozicion në versionet - VMware vCenter Server 8.0 (8.0U1d ose 8.0U2) , VMware vCenter Server 7.0 (7.0U3o), VMware Cloud Foundation 5 .x dhe 4.x.

Link: Lexo më shumë

Rruga "Papa Gjon Pali II", No.3
info@cesk.gov.al
Autoriteti Kombëtar për CESK
autoriteti_kombetar_cesk
+35542221039